- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
 - b) garanci bankare;
 - c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Lot. 1 “Aparatura per kirurgji”

1. NEUROMONITOR PËR TIROIDEN

Sistem me ekran me prekje i destinuar për monitorimin EMG gjatë operacioneve të tiroides, parotidës, nervit facial si dhe për çdo operacion ORL që kërkon monitorimin e nervave kraniale dhe periferikë motorikë.

Ekran me prekje, me ngjyra, i dukshëm në errësirë të plotë, minimalisht 10 inch me rezolucion jo më pak se 1024 x 600 piksel.

Mundësi lidhjeje për sonda monopolare dhe bipolare për stimulimin elektrik.

Të përmbajë opsionin e monitorimit deri në 2 kanale njëkohësisht.

Sensitiviteti të paktën në diapazonin 5 - 10000µV

Impedance e hyrjes jo më pak se 10 MOhm

CMR të paktën 90dB

Reagim zanor dhe vizual i sistemit gjatë stimulimit.

Shfaqja e modës së boshit kohor në milisekonda.

Paraqitje grafike e vendosjes së elektrodave në ekranin e pajisjes, sipas procedurës dhe nervit që monitorohet.

Kontroll automatik i impedancës së elektrodave të paktën në diapazonin 0-2Kohm

Kontrolli i elektrodave nepermjet rezistences. (Impedances)

Sinjalizime paralajmëruese nëse probet nuk janë vendosur siç duhet para dhe gjatë operacionit.

Të këtë softuer për zbulimin dhe bllokimin e artefakteve

Mundësi ndryshimi të intensitetit të stimulimit gjatë procedurës.

Aftësi për të punuar me dy stimulatorë me rryme konstante deri në 10mA

Gjerësia e pulsit të jetë e rregullueshme të paktën në diapazonin 50-300 µsek

Intervali pulseve të jetë i rregullueshëm të paktën në diapazonin: 10µsek – 100msek

Mundësi stimulimi të vazhdueshëm të nervit vagus me paraqitje grafike në ekranin e sistemit.

Të përmbajë opsionin e ruajtjes të të dhënave dhe raporti në njësi memorie të jashtme USB në formatin PDF.

Ndërfaqja e pacientit duhet të ketë kapëse për vendosje të sigurt në tavolinën / krevatin e operacionit.

Të jetë e pajisur me bateri me kohëzgjatje min 1 orë.

2- SET TRAPAN DHE SHARRË ORTOPEDE TË KENË MINIMALISHT :

Seti të jetë i përbërë nga një trapan, sharrë oshilante, karikuesi dhe kutia e sterilizimit

Trapani elektrik me bateri – 1 copë

Të jetë material titani

Të ketë fuqi të paktën 250W

Pesha të jetë jo më shumë se 1250g

Kanjulimi jo më pak se 4mm

Shpejtësia jo më pak se 25000rpm

Shtypja e butonit të komandimit të jetë porpocional me shpejtësinë

Të ketë çelës bllokues për të kufizuar shtypjen aksidentale të butonit të komandimit

Të ketë çelës për kthimin e xhirove mbrapsht

Kokat e shpimit të jenë të ndryshueshme

Të ketë kokë shpimi me moment rrotullimi jo më pak se 5Nm dhe shpejtësi 1000rpm

Të ketë kokë gërryese me moment rrotullimi jo më pak se 19Nm dhe shpejtësi 250rpm

Të jetë e autoklavueshme në 134°C

Të ketë kapakun për mbylljen e baterisë dhe adaptorët për vendosjen dhe heqjen e baterisë pa prishur sterilitetin

Të shoqërohet me 5 punto shpuese

Sharrë oshilante elektrike me bateri – 1 copë

Të jetë material titani

Të ketë fuqi të paktën 250 W

Pesha e plotë jo më shumë se 1600g përfshirë baterinë dhe kapakët

Shpejtësia jo më pak se 13000rpm

Mbajtësja e sharrës të jetë e rrotullueshme 360°

Fiksimi i sharrës të bëhet me mekanizëm automatik, pa çelës

Shtypja e butonit të komandimit të jetë porpocional me shpejtësinë

Të ketë çelës bllokues për të kufizuar shtypjen aksidentale të butonit të komandimit

Të jetë e autoklavueshme në 134°C

Të ketë kapakun e baterisë dhe adaptorët për vendosjen dhe heqjen e baterisë pa prishur sterilitetin

Të shoqërohet me 5 copë sharra të përmasave të ndryshme

Bateri minimalisht – 4 copë

Të jenë material NIMH

Të ketë energji jo më pak se 1.95Ah

Tensioni jo më pak se 9.6v

E njëjta bateri duhet të jetë kompatibël me trapanin dhe sharrën të kerkuara më lart

Karikuesi i baterive minimalisht– 1 copë

Karikuesi të ketë të paktën 4 vende për karikimin e baterive në mënyrë të njëkohshme
Të ketë idikator për statusin e baterisë për secilin nga pozicionet
Të funksionojë në 220 – 240V

Kutia e sterilizimit

Të ketë koshin për mbajtjen e sharrës, trapanit dhe aksesorëve të tjerë
Të ketë mbajtëse të dedikuar për secalin nga elementët
Të shoqërohet me furça, adaptor, vaj për motorra etj.

3- MORCELATOR

Morcellator laparoskopik i indeve të mëdha në mënyrë të shpejtë, efçente dhe të sigurtë
Të bëjë kryerjen e miomektomive dhe histerektomive pa përhapur asnjë ind në kavitetin abdominal
Sistem i morcelimit të indeve i përbërë nga: njësia e komandimit, kablo i rotorit, doreza morcelimit, qesja morcelimit

Njësia e komandimit të jetë me ekran me prekje

Me komandim të shpejtësisë me 8 shkallë dhe drejtimi të rrotullimeve

Doreza me të paktën 200 – 1400rpm

Furnizimi me energji elektrike të jetë sipas standardit të RSH 220 – 240 V 50/60Hz

Me komandim nga pedali

Me 2 modalitete prerje

Pesha e dorezës jo më shumë se 200g

Gjatësia e punës 160mm, diametric 14 – 15 mm

Qesja e morcelimit të jetë me 2 porta, 1 për morcelimin dhe 1 për optikën

Kapaciteti i qeses të jetë 2100 – 2150ml

Pajisja të jetë e pajisur me minimalishte aksesorët:

Pedal komandimi 2 copë,

Doreza morcelimi 5 copë,

Kablo rotorit 5 copë,

Qese morcelimi 5 copë.

4. SHTRAT OPERACIONI

Shtrat operator me jo më pak se 5 seksione modulare,

I përshtatshëm për ndërhyrjet kirurgjikale dhe transparent ndaj rrezeve X

Dyshek memory me veshje antistatike dhe kundër lëngjeve

Operim elektrohidraulik i lëvizjeve

Të jetë i pajisur me njësi kontrolli anësore dhe pult komandimi dore, bllokim automatik pas minimalisht 60 sekondash

Të ketë buton për resetimin e të gjitha lëvizjeve

Të jetë i pajisur minimalisht 4 rrota

Pjesa e shpinës jo më pak se 2 pjesë

Lartësia pa dyshek të paktën në diapazonin 68–98 cm

Gjatësia: ≥ 215 cm (duke përfshirë kokën)

Gjerësia: ≥ 54 cm, pa shina

Zgjatje gjatësore: ≥ 300 mm

Pozicione Trendelenburg/kundërt: $\geq 30^\circ$

Rregullime:

Shpinë të paktën në diapazonin -45° deri në $+80^\circ$

Zgjatimi i shpinës të paktën në diapazonin -45° deri në $+70^\circ$

Koka të paktën në diapazonin -90° deri në $+60^\circ$

Anësor të paktën në diapazonin -20° deri në $+20^\circ$

Pozicionet e refleksit/përkuljes të paktën në diapazonin 110/220°

Pesha mbajtëse: ≥ 250 kg

Seksioni i këmbëve: Poshtë / lart të paktën në diapazonin -90° deri në $+35^\circ$, Anësor të paktën në diapazonin deri në 90°

Aksesorët përfshirë të ketë të paktën :

Mbështetëse krahu me rrip – 2 copë

Kornizë anestezie – 1 copë
Mbështetëse shpatulle – 2 copë
Mbështetëse kofshe – 2 copë
Set për pllaka këmbë – 1 set
Rrip lidhës trupi – 1 copë
Morseta rrethore – 4 copë
Morseta katrore – 2 copë
Organizues fijesh – 1 copë
Set jastëkë silikoni rrethore për kokë (4 përmasa) – 1 set
Set jastëkë silikoni për gjymtyrë (2 përmasa) – 1 set

5. LLAMPË OPERATORE

Llampë ndriçimi kirurgjikale me bazë për fiksim në tavan me minimalisht dy krahë të rrotullueshëm $\geq 320^\circ$

E pajisur me dy koka (qëndrore dhe satelit) e përbërë me llampa LED

Kontroll iluminimi elektronik me panel komandimi me ekran touch screen

Iluminimi ne 1m për Qëndrorja: $\geq 160,000$ lux

Iluminimi ne 1m për Satelitorja : $\geq 130,000$ lux

Diametri i fushës i rregullueshëm elektronikisht të paktën në diapazonin 18–30 cm

Temperatura e dritës të paktën në diapazonin 800K – 5500K

Indeksi i rendimentit të ngjyrave: ≥ 95

Jetëgjatësia e LED $\geq 60,000$ orë

Dorezë sterilizueshme për rrotullim, ndryshim lartësie dhe këndit të llampës

Rrotullim horizontal dhe vertikal

Të jetë i pajisur me fiksuesi i llampës dhe mbulesa

Tensioni i punës sipas standartit të Republikës së Shqipërisë 240 V, 50-60 Hz

6. APARAT ANESTEZIE

Funksionim automatik me qark të mbyllur dhe fluks të ulët

Dalje shtesë për ventilim me qark të hapur

Sistem thithje CO₂ në qarkun e ventilimit, me ndërrim të rezervuarit pa ndërprerje

Sistemi me 3 gazra mjekësorë: O₂, N₂O dhe ajër; presioni i gazeve ne hyrje të paktën në diapazonin 2,8–6 atm

Flowmetër për çdo gaz me interval të paktën në diapazonin 0.2 – 15 L/min

Minimalisht 2 pozicione për vaporizatorë (minimum 1 vaporizues i përfshirë)

Dalje direkte 100% O₂ (Flush O₂)

Ekran LCD me ngjyra dhe touchscreen për ventilim dhe monitorim minimalisht 15"

Shfaqje simultane grafike në ekran te formave të valës minimalisht: Kurba Presion-Kohë, Kurba Fluks-Kohë

Shfaqje grafike e nje prej kurbave të spirometrisë minimalisht: Presion-Volum, Presion-Fluks, Fluks-Volum

Shfaqje numerike e parametrave të ventilimit minimalisht: Volum Tidal, Frekuenca e respirimit, raport I:E , Presion Inspirimit, Presion Maksimal, PEEP, Volumi/minutë, Volumi i Ekspirimit, %O₂ gjatë inspirimit.

Të ketë të përfshirë sistemin e shkarkimit të gazrave AGSS.

Modalitetet e Ventilimit : VCV,PCV,SIMV-VC,SIMV-PC,CPAP/PSV, PRVC, SIMV-PRVC dhe PSVPro.

Ventilimi Manual me valvol sigurie të rregullueshme deri në 70 cmH₂O

Karakteristikat e Ventilimit të paktën në diapazonet :

Volumi Tidal: 15-1500ml

Frekuenca e Respirimit: 4-100bpm për modalitet ventilimi të detyruar.

Raporti I/E: 4:1 deri në 1:10

PEEP: OFF, 3 - 30 cmH₂O

Presioni i Inspirimit: 5 - 70 cmH₂O

Koha e Inspirimit: 0,2- 5,0 sekonda

Karakteristikat e monitorimit:
Volum Tidal: 0–3000 ml
Presion në rrugët e frymëmarrjes: deri në 120 cmH₂O
Volum/minutë: 0–100 L/min
Alarmet që duhet të përmbajë :
Alarm i ulët / i lartë për % O₂
Alarm i ulët / i lartë për presionin maksimal
Alarm i ulët / i lartë për volumin / minutë
Furnizimi me energji: AC 100–240V / 50-60Hz
Bateri e integruar: ≥ 120 minuta
Aksesorë: Qark pacienti – 1 copë

7. ASPIRATOR KIRURGJIKAL

Pompë vakumi me kapacitet të paktën në diapazonin 670–700 mmHg
Kapacitet thithjeje ≥ 60 L/min
Rezervuari minimalisht 2 enë me volum min. 4 litra, të autoklavueshëm.
Kontroll i vakumit me pedale
Aksesorët përfshirë të ketë të paktën:
Tuba silikon
Filtra antibakteriale

Të gjitha paisjet duhet të kenë garanci minimalisht 12 muaj, dhe se operatori ekonomik duhet të ketë një teknik ose specialist / inxhinier të fushës ose të trajnuar i cili do të krvejë të gjitha instalimet e pajisjeve, gjithashtu dhe trajnimin e stafit. Të gjitha veprimet e sipërpërmendura do të dokumentohen me dokumentacion të dyanshëm. Pajisjet mjekësore duhet të jenë prodhim i tre viteve të fundit, 2022, 2023, 2024 ose vitit aktual 2025.

Lot.2 “Aparatura per gastrohepatologji”

SET ENDOSKOPIE FLEKSIBEL.

SISTEM VIDEO GASTRO-KOLONOSKOP

- VIDEO PROCESORI

Procesor imazhi me rezolucion minimalisht full HD 1080P dhe me burim të integruar të dritës LED.
Ndriçimi LED me temperaturë ngjyre të paktën në diapazonin 3000-7000K.
Pajisur me ekran me prekje jo më e vogël se 8 inch
Me funksion zmadhimi të figurës të paktën 2 herë.
Pajisur me modalitete për përmirësimin e imazhit, sipërfaqen, kontrastin dhe tonalitetin për të bere të mundur zbulimin dhe karakterizimin e lëzioneve në traktin digjestiv.
Sistemi të ketë tastierën specifike të tij.
Në pjesën e pasme të pajisjes së videoproçesorit duhet të jetë e pajisur me dalje DVI.
Pajisur me portë RJ45 dhe me të paktën 3 porta USB 3.0 për aksesimin dhe transferim e shpejtë të të dhënave në kujtesa të jashtme
Burimi i dritës duhet të sigurojë ndriçimin minimalisht me 2 LED
Burimi i dritës duhet të ketë funksionin e rregullimit automatik të intensitetit të dritës (të rritjes dhe zvogëlimit) nëse largohet shumë nga indet ose nëse afrohet.
Rregullimi manual i dritës duhet të jetë i mundur me burimin e dritës në të paktën 10 nivele
Rregullim i ngjyrave në të paktën 10 nivele.
Sistem ajri me pompë të lëvizshme të paktën në diapazonin 4,5KPA-6,5KPA
Furnizimi me ajër deri në të paktën 5 L/min
Të ketë funksion për balancimin e të bardhës
Të ketë funksion për maksimizimin e intensitetit e dritës
Të ketë funksion për rregullimin e shpejtësisë së grilës për imazh sa më të mirë

Të ketë funksion për eksportimin e historikut të procedurës në USB

Pajisja duhet të funksionojë me rrymë elektrike të paktën 50-60 Hz dhe voltazh 220V

- **MONITOR**

Monitori të jetë i gradës mjekësore, minimalisht full HD me ngjyra me përmasa mbi 26'' i dedikuar për endoskopi.

Të kete teknologji kundër reflektimit

Rezolucioni të jetë minimalisht 1920x1080

Ndriçimi maksimal - 1000 cd/m²

Kontrasti - 1000:1

Këndi i shikimit jo më pak 178° në të gjitha drejtimet

Koha e përgjigjes jo më shumë se 14 ms

MTBF jo më pak se 30,000 h

Të jetë e pajisur me hyrjet Video DVI-D, 3G-SDI.

Të jetë e pajisur me dalje Video DVI-D, 3G-SDI.

Shkalla e mbrojtjes nga uji dhe pluhurat minimalisht IP 65 ose më mirë

Të suportoje rrotullimin dhe pasqyrimin e imazhit

Të jetë e pajisur me ndërfaqje RS232 për adaptim të avancuar

- **VIDEOGASTROSKOP**

Pajisja videogastroskop duhet të jetë e përshtatshme për përdorim diagnostikues dhe terapeutik

Me teknologji CMOS për cilësi të lartë imazhi në rezolucion minimalisht HD 2Mpixel

Pamje ballore me kënd të gjerë të paktën 140 gradë,

Thellësia e fushës së shikimit të videogastroskopit të paktën në diapazonin 3-100 mm ose më mirë.

Diametri i jashtëm i tubit të futjes së videogastroskopit duhet të jetë më i vogël se 10,5 mm

Kanali i punës së videogastroskopit duhet të ketë një diametër të brendshëm nga 2,8mm.

Gjatësi e dobishme e punës së videogastroskopit të jetë të paktën 1050 mm

Kapaciteti i lakimit të majës së videogastroskopit duhet të jetë lart / poshtë: min.210/110 gradë dhe majtas / djathtas: min 100/100 gradë.

Skopi përveç kanalit ujë / ajër të ketë një kanal të veçantë për nxjerrjen e ujit me presion për pastrimin e lenteve nga papastërtitë dhe hemoragjitë

Të ketë të paktën 3 butona për komanda të kontrolluara nga videoendoskopet, si psh freezing etj.

Furnizuar me çantë transporti dhe aksesore pastrimi

- **VIDEOKOLONOSKOP**

Pajisja videogastroskop duhet të jetë e përshtatshme për përdorim diagnostikues.

Me teknologji CMOS për cilësi të lartë imazhi në rezolucion minimalisht HD 60 FPS

Pamje ballore me kënd të gjerë të paktën 140 gradë.

Thellësia e fushës së shikimit të videokolonoskopit duhet të jetë midis 3-100 mm ose më mirë.

Tubi i futjes së videokolonoskopit të ketë fleksibilitet të ndryshueshëm dhe diametër më të vogël se 13.8 mm.

Pajisur me mekanizëm kthimi të menjëhershëm të tubit për të siguruar efikasitet të lartë dhe komoditetin e pacientit.

Kanall i punës së videogastroskopit duhet të ketë një diametër të brendshëm prej të paktën 3.8 mm.

Gjatësia e dobishme e punës së videogastroskopit të jetë të paktën 1350 mm .

Kapaciteti i lakimit të majës së videokolonoskopit duhet të jetë lart / poshtë: min. 180/180 gradë dhe majtas / djathtas: min 160/160 gradë.

Skopi përveç kanalit ujë / ajër të ketë një kanal të veçantë për nxjerrjen e ujit me presion për pastrimin e lenteve nga papastërtitë dhe hemoragjitë

Të ketë të paktën 3 butona për komanda të kontrolluara nga videoendoskopet si p.sh. freezing etj.

Furnizuar me çantë transporti dhe aksesore pastrimi

- **ASPIRATOR**

Pajisje portative për tu vendosur në karrelin e endoskopisë

Aspirimi i gradueshëm jo më shumë se 40 L/min

Thithja maksimale: -0.80 bar (600mm/Hg)

Pajisur me shishe min. 1L .

Niveli i zhurmës jo më shumë se 65 dBA

Të përfshijë të gjithë aksesorët gati për punë

Të jetë i pajisur me filtër antibakterial dhe hidrofobik dhe tuba lidhës silikon.

Të gjithë aksesorët të jenë të autoklavueshëm

Niveli i mbrojtjes ndaj lagështisë, pluhurave jo më poshtë se IP 21

- **KARREL ENDOSKOPIK :**

Të jetë i pajisur me 4 rrota dhe me mekanizëm bllokimi

Të jetë i pajisur me trasformator izolues.

Të jetë i pajisur me të paktën 3 ndarje dhe një sirtar për tastierën

Të jetë i pajisur me krah për mbajtjen e monitorit dhe të jetë i lëvizshëm

Të jetë i pajisur me krah për mbajtjen e skopeve me lartësi të rregullueshme,

Karrel i të jetë robust dhe me peshë mbajtëse të paktën 40 Kg për raft

- **MAKINE LARËSE DHE DEZINFEKTUESE**

Të jetë i aprovuar nga prodhuesi i skopeve.

E përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e video-endoskopëve të mësipërm.

Me fluks të paktën 600ml/min dhe kohë riqarkullimi prej të paktën 60 minuta.

Të jetë e pajisur me ekran për shfaqjen e kohës totale dhe kohës së mbetur

Të jetë e pajisur me të gjithë tubat .

Të ketë një kontrollues presioni (presioni maksimal 0,8 bar) për të parandaluar çdo dëmtim të kanaleve.

Të gjitha kanalet ajër / ujë, thithje dhe kanali i biopsisë të verifikohen në mënyrë elektronike.

Mundëson përdoruesin të dezinfektojë një endoskop midis dy ekzaminimeve shumë lehtë.

Pastrim me shplarje i të gjitha kanaleve për të parandaluar depozitimet ose bllokimin e kanaleve

Të ketë alarme vizuale dhe akustike që tregojnë kur një kanal është i bllokuar.

Të punojë me zhurmë sa më të ulët.

Të jetë e pajisur me dy kontenerë të veçantë për larjen dhe dezinfektimin e endoskopëve.

- **KABINET PËR THARJEN E ENDOSKOPËVE**

Materiali minimalisht çelik inox i klasës 304

4 ose më shumë mbajtëse endoskopi të projektuara për të parandaluar dëmtimet e pajisjeve

Varëse endoskopi prej materiali kompakt.

Të ketë vrima për qarkullimin e ajrit

- **AKSESORË TË TJERË TË SISTEMIT ENDOSKOPIK**

Pajisje për testimin e rrjedhjes të endoskopëve (min. 1 copë)

Blllokues kafshimi min. 10 copë (bite-block)

Solucion larës dhe dezinfektues (të përshtatshëm për pajisjen larëse)

- **SISTEM VIDEO-BRONKOSKOP**

Për përdorim në urgjencë, reanimacion dhe në kabinetin e bronkoskopisë

- **VIDEO PROCESORI**

Procesor imazhi me rezolucion full HD (1080x1920) me 2 llampa LED të integruara

Ndërfaqe përdorimi e lehtë dhe intuitive ;

Pajisur me portë RJ45 për lidhje në sistemin spitalor dhe të paktën 2 porta USB 3.0 për aksesore dhe transferim të dhënash në kujtesa të jashtme

Sistemi të mundet të lidhet me tastierën specifike të tij.

- **EKRANI**

Ekran mjekësor minimalisht full HD 24 inch me karrel.

- **ASPIRATOR**

Pajisje portative për tu vendosur në karrelin e endoskopisë
Aspirimi i gradueshëm deri në 40 L/min
Thithja maksimale: -0.80 bar (600mm/Hg)
Pajisur me shishe 1L .
Niveli i zhurmës jo më shumë se 65 dBA
Të përfshijë të gjithë aksesorët gati për punë
Të jetë i pajisur me filtër antibakterial dhe hidrofobik dhe tuba lidhës silikon.
Të gjithë aksesorët të jenë të autoklavueshëm
Niveli i mbrojtjes ndaj lagështisë, pluhurave minimalisht IP 21
Video-bronkoskop shumëpërdorimësh për intubim
Kompatibël me video-procesorin e mësipërm
Diametri i jashtëm i tubit më i vogël se 4.9 mm dhe gjatësia e punës të paktën 60cm
Pamje ballore me kënd të gjerë, të paktën 120 gradë
Kthyeshmëria e majës të paktën lart / poshtë: 180/130 gradë dhe majtas / djathtas 120/120 gradë.
Pajisur me kanal pune për instrumenta dhe aspirim të shpejtë, me diametër të paktën 2mm

- **Video-bronkoskop terapeutik**

Kompatibël me video-procesorin e mësipërm
Diametri i jashtëm i tubit më i vogël se 5.9 mm dhe gjatësia e punës të paktën 60cm.
Pamje ballore me kënd të gjerë, të paktën 120 gradë
Kthyeshmëria e majës të paktën lart / poshtë: 180 / 130 gradë dhe majtas / djathtas 120/120 gradë.
Pajisur me kanal pune për instrumenta, me diametër të paktën 2.8 mm

Të gjitha paisjet duhet të kenë garanci minimalisht 12 muaj, dhe se operatori ekonomik duhet të ketë një teknik ose specialist / inxhinier të fushës ose të trajnuar i cili do të kryejë të gjitha instalimet e pajisjeve, gjithashtu dhe trajnimin e stafit. Të gjitha veprimet e sipërpërmendura do të dokumentohen me dokumentacion të dyanshëm. Pajisjet mjekësore duhet të jenë prodhim i tre viteve të fundit, 2022, 2023, 2024 ose vitit aktual 2025.

Lot.3 “Aparatura per paliativin”

KABINET BIOSIGURIE KLASA II

- Qëllimi i përdorimit: Për përgatitjen e citostatikëve, të jetë kapë e cila të mundësojë përpunimin e lëndëve toksike volatile dhe radionuklideve të përdorura në disa disiplina si mikrobiologji, virologji, hematologji, kultura qelizore, gjenetikë si dhe trajtim/përpunimin e agjentëve të rrezikshëm për njeriun
- Të funksionojë me qarkullim të ajrit me fluks laminar vertikal, në mënyrë që të ofrojë mbrojtje të trefishtë për operatorin, mjedisin dhe vetë produktin.
- Sistemi i shkarkimit të mundësojë përpunimin dhe shkarkimin e 100% të ajrit
- Të jetë i pajisur me ventilatorin kryesor të motorit dhe ventilator të integruar të shkarkimit
- E gjithë pjesa e brendshme e kapës të jetë me çelik inox
- Sistemi i ajrimit të sigurojë filtrim HEPA në sipërfaqen e punës
- Të ketë llampë germicidale UV
- Kapa të jetë me xham të temperuar me një kënd minimalisht 7° për të siguruar fushëpamje maksimale në dhomën e kapës
- Kapa të ketë një ndriçim të inkorporuar me tuba fluoreshente të cilat të japin një ndriçim jo më pak se 1200 Lumen në sipërfaqen e punës
- Funksionet e kapës të jenë të kontrolluara me anë të mikroprocesorit
- Brenda dhomës së kapës të ketë të paktën 2 dalje elektrike me mbrojtje
- Përmasat e përafërta: Gjerësi 100 – 150 cm, Thellësi 70 – 90 cm, Lartësi 200 – 240 cm

- Filtrim me efikasitet mbi 99,995% MPPS për grimca me përmasa maksimalisht 0.3 mikron
- Të ketë funksionim silencioz
- Kapa të jetë e pajisur me ekran LCD për afishimin e vazhdueshëm të parametrave që të mundësojë përzgjedhje të opsioneve më dorashka
- Të ketë alarme audio dhe vizive për këto funksione: fluksi i ajrit laminar jashtë parametrave të caktuar, pozicionim jo i duhur i dritares së xhamit, bllokim i filtrit HEPA, keqfunksionim i motorrit të ventilatorit.
- Garancia e kapave dhe aksesoreve të jetë minimalisht 1 vit për çdo defekt të mundshëm. Instalimi, testimi, kalibrimet (në rast se është e nevojshme) si dhe trajnimi i personelit do të kryhet nga OE.

Të gjitha paisjet duhet të kenë garanci minimalisht 12 muaj, dhe se operatori ekonomik duhet të ketë një teknik ose specialist / inxhinier të fushës ose të trajnuar i cili do të kryejë të gjitha instalimet e pajisjeve, gjithashtu dhe trajnimin e stafit. Të gjitha veprimet e sipërpërmendura do të dokumentohen me dokumentacion të dyanshëm. Pajisjet mjekësore duhet të jenë prodhim i tre viteve të fundit, 2022, 2023, 2024 ose vitit aktual 2025.

Lot. 4 “Aparatura te pergjithshme”

1 – ELEKTROKARDIOGRAMË (EKG)

Standardet e Sigurisë:

Për funksion mbrojtës ndaj defibrilimit pajisja duhet të jetë e pajisur minimalisht me çertifikimet ISO 13485:2016, me shenjë CE në përputhje me MDD 93/42/EEC, IEC 60601-1, IEC 60601-2-25, IEC 62304, ANSI/AAMI EC-11, Klasa I, me furnizim të brendshëm të energjisë, tipi CF.

Karakteristikat Fizike:

Madhësia e produktit: jo më shumë se 410mm × 316mm × 135.8mm

Mjedisi i Funksionimit:

Furnizimi me energji:

- Sipas standardit të Republikës së Shqipërisë 240V~, 50/60Hz ±1Hz,
- Të jetë e pajisur me bateri të rikarikueshme Lithium-ion, me kapacitet të baterisë jo më pak se 4400mAh,
- Koha e karikimit të baterisë jo më shumë se 6 orë për karikim,
- Paisja të funksionojë jo më pak se 2 orë punë e vazhdueshme,
- Ekрани të jetë LCD me prekje, me ngjyra dhe me madhësi përafërsisht 8.5”,
- Rezolucioni të jetë minimalisht 800×600,
- Sinjalet e gjurmara jo më shumë se 12 valëformë.

Treguesit / indikatorët:

Paisja te jete e pajisur minimalisht me:

- Treguesin e energjisë,
- Treguesin e baterisë,
- Sinjali zanor QRS,
- Tingulli i tasteve gjatë përdorimit,
- Ndriçim i pasmë i tasteve

Paisja duhet te jete e pajisur minimalisht me :

- Kabllin e parametrave

- Priza e hyrjes për furnizim me energji AC
- Dy porta USB
- Portë RJ45

Ruajtja e të dhënave:

- Të jetë e pajisur me portë për kartë micro-SD standarde minimalisht 8G për 40,000 EKG,
- Memorie e brendshme për jo më pak se 300 raste pacientësh
- Rrjeti: I lidhur me PC ECG me kablllo/Wireless

Shfaqja e ekranit:

Parametrat e shfaqur të kenë minimalisht: ID e pacientit, gjinia, mosha, valëformave, shpejtësia e regjistrimit/shtypjes, fitimi, filtri EMG, rrahjet e zemrës (HR), statusi i elektrodave, ora, mesazhet informative.

Formatet e shfaqjes të kenë minimalisht: 3×4, 3×4+1R, 3×4+3R, 6×2, 6×2+1R, 1×12, 1×12+T

Koha automatike e fikjes për kursim energjie të përmbajë alternativat: OFF, 1 min, 5 min, 10 min, 30 min

Të jetë e pajisur me tastierë

Printimi :

Lloji: I integruar; termik me matriks

Gjerësia e regjistrimit të jetë me parametrat minimalisht : 216mm / 210mm

Shpejtësia të përmbajë minimalisht: 5mm/s, 10mm/s, 12.5mm/s, 25mm/s, 50mm/s

Formati i printimit të ketë minimalisht: 3×4, 3×4+1R, 3×4+3R, 6×2, 6×2+1R, 1×12, 1×12+T

Të ketë mundësi lidhje me printer të jashtëm, me të njëjtat formate si më sipër

Informacioni i printimit të jetë opsional me opsione minimalisht: OFF, Bazik, i Detajuar

Mundësi për pishikimi diagnostik jo më shumë se 2-minutësh për të gjitha 12 valëformave

Opsionet për EKG

Opsion për analizimin e 12 kanaleve

Përzgjedhja e kanaleve opsionale dhe të përmbajë minimalisht: 12-kanale: I, II, III, aVR, aVL, aVF, V1-V6

Përzgjedhja e filtrimit të jetë opsionale dhe të përmbajë jo me pak se keto te dhena: 2.5mm/mV, 5mm/mV, 10mm/mV, 20mm/mV, 20/10mm/mV, 10/5mm/mV dhe AGC (gabim ±2%)

Shpejtësia e skanimit të jetë opsionale dhe të përmbajë: 5mm/s, 10mm/s, 12.5mm/s, 25mm/s, 50mm/s

Diapazoni i rrahjeve të zemrës të përmbajë : 30-300 bpm

Rezolucioni jo më pak se 1 bpm

Paisja e EKG duhet të përmbajë opsione mbrojtje

Filtri i driftit opsional dhe minimalisht: OFF, 0.05Hz, 0.10Hz, 0.20Hz, 0.50Hz

Filtri EMG opsional dhe minimalisht: OFF, 25Hz, 35Hz, 45Hz

Filtri i kalimit të ulët opsional dhe minimalisht: OFF, 75Hz, 100Hz, 150Hz

Filtri AC opsional dhe minimalisht: OFF, 50Hz, 60Hz

Mbrojtja: të jetë e pajisur me izolim që ti rezistojë minimalisht 4000VAC/50Hz, Kundër ndërhyrjeve nga elektro-kirurgjia dhe defibrilimi

Të jetë e pajisur me opsione për Analizimin e Aritmisë me jo më pak se 120 lloje.

2- DEFIBRILATOR

Defibrilator Bi-Fazik me Pacer për arrestet kardiake akute dhe kronike

Me karikues dhe bateri.

Të ketë peshë të lehtë (<8 kg)

Kërkesat e energjisë:

Tensioni i hyrjes 220-240 V, 50/60Hz;

Të ketë mundësinë e punës në mënyrën e defibrilimit të jashtëm manual dhe automatik (AED).

Zgjedhja manuale maksimale të jetë deri në 360 J.

Diapazoni i energjise: min 1- 360 J

Koha e karikimit. 3-6 sec për energji 200J

Monitor LCD me ngjyra / ekran TFT me ngjyra me rezolucion të lartë minimumi 8", shfaqje e 4 formvalëve njëkohësisht.

Mundësi Monitorim te formave valore: EKG, HR, pacing etj.

Duhet të monitorohet EKG përmes paddles, pads dhe elektrodave të monitorimit dhe

Defibrilim përmes pads dhe paddles.

Duhet të ketë ndërrimin automatik të Lead për të parë EKG-në e pacientit përmes paddles ose leads.

Duhet të ketë çelësin e drejtpërdrejtë të pershtatjes dhe çelësat e funksionit të drejtpërdrejtë për mute dhe freeze.

Mundësi regjistrimi të valeve të EKG në regjistruerit termikë.

Duhet të jetë me shpejtësi EKG 25mm / sek.

Duhet të ketë cilësimin e alarmeve të zgjedhura nga përdoruesit.

Duhet të ketë Defibrilim automatik dhe manual

Mënyrat e punës: Manuale, Pacer, AED.

Të ketë të instaluar funksionin për ECG

Duhet të ketë regjistruer automatik dhe manual të integruar për shtypjen e informacionit të ruajtur të EKG-së.

Me tregues dixhital në ekran të gjendjes së baterisë.

Kapaciteti i baterisë: minimumi 200 goditje në nivelin e energjisë 200J

Koha e karikimit të baterisë: 4-5 orë.

Treguesi i karikimit të jetë në ekran.

Pajisur me printer termik

Duhet të ketë lehtësi përmbledhëse të ngjarjeve për regjistrimin dhe shtypjen të paktën 250 ngjarje dhe 50 forma valësh.

Me kartë memorie për mundësi rregjistrimi deri në 150 orë

Ndërfaqe e përshtatshme dhe e shpejtë USB dhe rrjeti

Dorezë të inkuorporuar.

Të ketë mbrojtje nga uji IP44

Makineria duhet të ketë pajisje defibrilator për të rritur dhe foshnje.

Të shoqërohet me aksesoret minimalisht : 1 copë kabell EKG me 5 lead, 1 copë Set pllakash të ripërdorshme adulte dhe pediatrike, 1 copë Set pllakash një përdorimshe adulte dhe pediatrike, 10 copë Elektroda EKG njëpërdorimshe, 1 copë rulon letër termike për printer, 1 copë shishe xhel.

3- ELEKTROBISTURI

Elektrobisturia duhet të jetë një pajisje elektro-kirurgjikale me frekuencë të lartë, të përshtatshme për të siguruar energji për prerje dhe koagulim monopolar (me nivele të ndryshme të koagulimit), si dhe për prerje dhe koagulim bipolar.

Aktivitet operativ i dyfishtë

- Minimalisht dy kanale dalje për prerje monopolar
- Minimalisht dy kanale të pavarura për vendosje dhe dalje për koagulimin monopolar më të zakonshëm

Paisja të ketë minimalisht këto procedura prerjeje të kontrolluara

- rrymë prerjeje e përmirësuar për incizione pa eshkarë
- rrymë prerjeje me veti të zgjedhshme koaguluese për diseksion me kontroll të gjakderdhjes
- lidhje kapacitive e ulët përmes rrymës BLEND të ngadaltë për procedura endoskopike

Paisja të ketë minimalisht këto procedura koagulimi të kontrolluara dhe të dyfishta

- koagulim SPEEDY dhe DEEP në dispozicion për minimalisht dy operatorë
- koagulim SPRAY i kontrolluar përmes komandës me dorë ose pedale

Paisja të ketë minimalisht këto veçori të gjera të koagulimit bipolar

- rrymë prerjeje bipolare me kontroll të zgjedhshëm të gjakderdhjes
- rrymë prerjeje BLEND e ngadaltë
- funksione automatike të nisjes/ndaljes për koagulimin

Të ketë siguri e plotë për kirurgun dhe pacientin

- pranueshmëria e impedancës së kontaktit midis trupit të pacientit dhe elektrodës së kthimit monitorohet vazhdimisht nga Kontrolli Elektronik i Pllakës së Lëkurës (SPEC)
- rrjedhjet e rrymës me frekuencë të lartë monitorohen vazhdimisht
- luhatjet e tensionit të rrjetit kompensohen automatikisht përpara se të jepet rryma HF

Procedura të personalizuar

- zgjedhje e pavarur e llojeve të rrymës së koagulimit dhe niveleve të fuqisë minimalisht prej dy operatorëve
- Minimalisht maksimalisht 10 procedura mund të konfigurohen dhe të rikujtohen

SINJALE SHITESË DHE NDËRVEPRIMI ME PAJISJE TË TJERA

- lidhje e daljes për përdorim me njësi të jashtme të plazmës Argon dhe të thithjes së tymit

Diagnozë automatike vetëkontrolluese

- kontroll diagnostik automatik i funksionalitetit të plotë të njësisë elektronike dhe aksesorëve të lidhur, me raportim të koduar të gabimeve

SPECIFIKIME TEKNIKE

- Njësi elektrokirurgjike me fuqi të lartë maksimalisht 400 Watt

Parametri Teknik

Fuqia maksimale dalje (monopolar, prerje e pastër – CUT)	Maksimalisht 400 W – 300 Ω
Prerje & koagulim monopolar CUT 80%	Maksimalisht 350 W – 300 Ω
Prerje & koagulim monopolar CUT 60%	Maksimalisht 250 W – 300 Ω
Prerje & koagulim monopolar CUT 40%	Maksimalisht 200 W – 300 Ω
Prerje monopolar ENHANCED	Maksimalisht 250 W – 500 Ω
Prerje & koagulim monopolar BLEND	Maksimalisht 250 W – 300 Ω
Koagulim monopolar SPEEDY	Maksimalisht 120 W – 500 Ω
Koagulim monopolar DEEP	Maksimalisht 120 W – 200 Ω

Parametri Teknik

Koagulim monopolar SPRAY	Maksimalisht 100 W – 2000 Ω
Koagulim SPRAY me Argon	Maksimalisht 100 W – 2000 Ω
